



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; eee.gjk-ks.org

Prishtinë, datë: 24 March 2010
Ref. Nr.: TK 11/10

VENDIMI PËR HEQJEN NGA LISTA TË KËRKESËS

Rasti Nr. KI. 27/09,

Rafet Hoxha

vs

Vendimit të Gjykatës Supreme Nr. Pn.nr 168/2005

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë prej:

Enver Hasani, Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtar
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar dhe
Altay Suroy, Gjyqtar

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi i Kërkesës është Rafet Hoxha, i përfaqësuar nga Z. Hamdi Podvorica, avokat në Prishtinë.

Objekti i Shqyrtimit

2. Parashtruesi i kërkesës paraqiti një Kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me 13 korrik 2009. Në kërkesën e tij, Parashtruesi ankohet se të drejtat e tij, që garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (me tej si Kushtetuta) janë shkelur nga Vendimi i Gjykatës Supreme No.Pr.168/2005 i datës 7 korrik 2005 (me tej si: Vendimi i Gjykatës Supreme).

Bazat juridike

3. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës(më tej si: Kushtetuta), Neni 20 i Ligjit Nr.03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës(më tej si: Ligji), dhe Neni 32 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Kosovës (më tej si: Rregullorja e Punës).

Përmbledhja e fakteve

4. Vendimi i Gjykatës Supreme konfirmoi Vendimin Kp.Nr. 120/2005 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i cili rezultoi se të gjitha kushtet paraprake për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës në Norvegji, të parapara në Marrëveshjen e 22 tetorit 2004 të nënshkruara nga UNMIK dhe Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, janë plotësuar.

5. Marrëveshja e sipërpërmendur midis Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë(më tej si: UNMIK) dhe Mbretërisë së Norvegjisë parashikon dorëzimin e Parashtruesit të Kërkesës në Mbretërinë e Norvegjisë, meqenëse autoritetet norvegjeze kane filluar procedurat penale kundër Parashtruesit për veprën penale të vrasjes, e cila supozohet të ketë ndodhur me 31 mars 2003.

Përmbledhje e procedurës në Gjykatë.

6. Parashtruesi i Kërkesës dorëzoi Kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese me 30 korrik 2009. Parashtruesi, në kërkesën e tij ankohet se të drejtat e tij të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës(më tej si Kushtetuta) janë shkelur nga Vendimi i Gjykatës Supreme No.Pr.168/2005 i datës 7 korrik 2005(më tej si: Vendimi i Gjykatës Supreme).

7. Me 13 tetor 2009, Parashtruesi plotësoi më tej Kërkesën e tij me një Kërkesë, në të cilën kërkohej vendosja e Masës së Përkohshme, ku kërkonte pezullimin e procedurës lidhur me transferimin e tij në Norvegji, deri sa Gjykata Kushtetuese të lëshonte Vendimin e saj përfundimtar.

8. Me 15 dhjetor 2009, Gjykata Kushtetuese vendosi të hedhë poshtë Kërkesën e Parashtruesit për vendosjen e Masës së Përkohshme, pa paragjykuar vendimin përfundimtar të Kërkesës.

9. Përfaqësuesi i Parashtruesit informoi Gjykatën me anë të një letre me datë 28 dhjetor 2009, në të cilën thuhej se Parashtruesi nuk dëshironte të vazhdonte më procedurën lidhur me Kërkesën e tij.

Vlerësimi i Gjykatës

10. Në mënyrë që të vendosim lidhur me kërkesën e Parashtruesit për të mos vazhduar më me rastin e Tij, Gjykata Kushtetuese duhet fillimisht të ekzaminojë nëse kushtet e parashikuara në rregulloren e Punës janë plotësuar.

11. Neni 32 i Rregullores së Punës, në pjesën përkatëse parasheh për sa vijon:

“Tërheqja e Kërkesës”

(1) Pala e cila e ka parashtruar kërkesën mund ta tërheq atë në çfarëdo kohe para fillimit të seancës dëgjimore për atë kërkesë.

(2) Pavarësisht tërheqjes në pajtim me paragrafin (1), Gjykata mund të zgjedh të vendos në lidhje me atë kërkesë. Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në atë kërkesë dhe përgjigje, në rast se përgjigja është parashtruar, dhe çfarëdo dokumentesh të bashkëngjitura asaj.

...."

12. Me 18 shkurt 2010, bazuar në zhvillimet e mësipërme, Gjyqtari Raportues, Ivan Čukalović, i rekomandoi Kolegjit Shqyrtues, i përbërë prej Gjyqtarëve Robert Carolan, (Kryesues), Snezhana Botusharova dhe Altay Suroy, të ndërpresin ekzaminimin e mëtejshëm të Kërkesës. Pasi rekomandimit të Gjyqtarit Raportues, Kolegji Shqyrtues u pajtua se nuk ka rrethana të jashtëzakonshme lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat kërkojnë ekzaminim të mëtejshëm të Kërkesës dhe në të njëjtën datë i përcolli Gjykatës Rekomandimin e tyre.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, sipas Nenit 20 të Ligjit dhe Nenit 32 të Rregullores së Punës, në mënyrë unanime,

VENDOS

I. Heqjen e Kërkesës nga lista.

II. Ky Vendim do t'ju njoftohet Palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Ivan Čukalović

Prof. Dr. Enver Hasani

